

KAMPI I OSBE-së PËR FUQIZIMIN E RINISË PËR PJESËTARËT E KOMUNITETIT ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN TË KOSOVËS

>>13 - 15 shtator 2019

THIRRJE PËR APLIKIM

AFATI PËR APLIKIM

29 gusht 2019

PËRSHKRIMI I KAMPIT RINOR

Misioni i OSBE-së në Kosovë do të organizojë një kamp për fuqizimin e rinisë (kamp rinor) për studentët universitarë dhe të sapodiplomuarit nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës nga 13 deri më 15 shtator 2019.

Kampi rinor do të përfshijë seanca për shkrimin efektiv të biografive, letrave të rekomandimit, simulim të intervistave dhe/ose shkathtësive të buta të trajnimit. Për më tepër, organizatat partnere do të mbajnë seanca për atë se si të themelohet një kompani, si të shkruhet një bllog, si të bëheni pjesëtar i Policisë së Kosovës dhe se si të përvetësohet përvoja e parë profesionale përmes punës vullnetare.

Pjesëtarë të dalluar të të tri këtyre komuniteteve do të ftohen si folës mysafirë për të diskutuar mbi përvojën e tyre dhe rrugën e tyre drejt suksesit, me qëllim të frymëzimit të pjesëmarrësve.

Kampi Rinor mëton të kontribuojë në forcimin e shkathtësive të punësimit të studentëve të rinj dhe të posa diplomuarve nga radhët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian të Kosovës. Në veçanti, kampi rinor synon që:

- Të ofrojë trajnim shtesë për kërkimin e vendit të punës dhe për shkathtësitë thelbësore profesionale për të përgatitur të rinjtë që të jenë punonjës dinamik, të motivuar dhe të ndërgjegjshëm.*
- Të sigurojë një mjedis përkrahës që u mundëson atyre që të angazhohen në kuptimin shoqëror me moderatorët dhe kolegët e tyre të cilët kërkojnë udhëzime për karrierë, duke ushtruar kështu ndikim pozitiv mes bashkëmoshatarëve.*
- Të rritë vetëbesimin si pasojë e ekspozimit dhe punës praktike. Simulimi i tre hapave të mundshëm të radhës që i motivojnë studentët që të përcaktojnë dhe punojnë drejt qëllimeve reale.*

Temat në vijim do të mbulohen gjatë Kampit Rinor:

Seanca 1: Biografite (CV) dhe letrat e rekomandimit që funksionojnë!

Seanca 2: Teknikat e intervistave!

Seanca 3: Strategjitë e kërkimit të vendit të punës!

Seanca 4: Forcimi i shkathtësive të shkrimit dhe se si të krijoni bllogun tuaj!

Seanca 5: Krijimi i ideve tuaja të biznesit dhe themelimi i kompanisë suaj!

Seanca 6: Si të bëheni vullnetar?

Seanca 7: Si të bëheni pjesëtar i Policisë së Kosovës!

KRITERET E PRANUESHMËRISË

Kriteret e pranueshmërisë janë si në vijim:

1. Të qenit pjesëtar i komunitetit rom, ashkali apo egjiptian të Kosovës.
2. Të qenit i student pasuniversitar apo universitar apo i diplomuar gjatë dy viteve të fundit.
3. I/e lindur më apo pas datës 1 janar 1994.
4. Të qenit aktualisht i papunë ose jo me punësim me orar të plotë me pagesë.

SHPENZIMET E KAMPIT

Pagesa për kamp, materialet dhe akomodimi me ushqim me tre vakte do të mbulohen nga organizatorët. Transporti do të sigurohet nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

PROCESI I APLIKIMIT

Formularët e aplikimit janë në dispozicion në këtë [vegjë](#). Organizatorët i inkurajojnë të gjithë kandidatët, pa marrë parasysh gjininë a paaftësinë, që të aplikojnë. Ju lutemi na informoni nëse ju duhet ndihma në lidhje me paaftësinë, me qëllim që të kompletohet procesi i aplikimit. Afati për aplikime 29 gusht 2019.

Për më shumë informata dhe pyetje, ju lutemi kontaktoni znj. Vanja Kovac në vanja.kovac@osce.org